

Shoqeria "DRAGO" Shpk
Nipt K73919201E
Adresa: Nikel-Qender, Kruje

Tirane me 12.05.2014

KONTRATE DHURIMI TE KUOTAVE KAPITALIT TE SHOQERISE "DRAGO" Shpk

Ne Tirane, sot me daten 12.05.2014, ne palet e meposhte shenuara:

1. Hamdi Mesi , i biri i Shabanit, i date lindjes 21.05.1949, me leternjoftimi E90521024S, lindur ne Nikel - Kruje dhe banues ne Nikel - Kruje, ortak i vetem themelues i shoqerise "Drago" shpk e regjistruar ne QKR me 25.09.2006, me Nipt K73919201E, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, ketu e me poshte do te quhet **Dhuruesi** .
2. Erind Kosova , i biri i Bajramit, i date lindjes 30.04.1982, me leter njoftimi I20430059D, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili ketu e me poshte do te quhet **pranues i dhurimit**.

Te dy palet, bazuar ne vullnetin e plote dhe te lire dhe mbeshtetur ne kodin civil dhe vecanrisht, ne ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe posacerisht neni 73, pika 1, germa ç dhe pika 2, si dhe ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" hartojme kete kontrate dhurimi te kuotave te kapitalit ne shoqerine tregtare "DRAGO" Shpk.

1. **Dhuruesi** Hamdi Mesi, me gjeneralitet e mesiperme, zotrues i 100% te kuotave te kapitalit ne shoqerine "Drago" shpk, te regjistruar ne QKR me Nipt K73919201E, ne baze te vendimit te ortakut te vetem nr.4 date 09.05.2014 ,vendosi t'i dhuroj nipit vet, Erind Bajram Kosova, 100% te kuotave te kapitalit, ose 100 kuota me vlere totale 35.700.000 leke, te cilat ai i zotron ne shoqeri:
2. **Pranuesi i dhurimit** , Erind Kosova, eshte dakort me kete dhurim dhe e pranon dhurimin e mesiperm. Pas nenshkrimit te kesaj kontrate behet pronar i 100% te kuotave te kapitalit ne shoqerine "Drago" shpk.

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga shuma prej **35.700.000** leke, shume e percaktuar ne baze te vullnetit te Ortakut te vetem te shoqerise.



Ky kapital eshte i ndare, ne 100 kuota me vlere nominale prej 357.000 leke, per cdo kuote te shlyer per teresine e vleres nominale te tyre. Kuotat jane te numeruara nga 1 deri 100.

Ortaku i ri i shoqerise eshte:

1. Erind Kosova , i biri i Bajramit i date lindjes 30.04.1982 me leter njoftimi I20430059D, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, i cili behet zotrues i 100% te kuotave ose 100 kuota me vlere **35.700.000** leke.

Objekti veprimtarise se shoqerise nuk ndryshon por ortaku do te hartoje statutin e ri te shoqerise, me qellim sakesimin e detyrimeve midis Ortakut te vetem.

Selia e shoqerise:

Selia kryesore e shoqerise do te qendroj Komunen Nikel – Qender, rrethi Kruje ,qarku Durres.

Dispozita te fundit

Kjo kontrate per transferimin kuotave te kapitalit te shoqerise hartohet ne 3 kopje te barabarta dhe nenshkruhet rregullisht nga palet.

Dhuruesi
Hamdi Mesi



Pranuesi i dhurimit
Erind Kosova

